

OPERATOR SISTEMI TRANSMISIONI DHE TREGU S.H.A.  
TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR I.S.C.  
OPERATOR SISTEMA, PRENSA I TRZISTA A.D.



# RAPORT VJETOR .2013



**RAPORT  
VJETOR  
.2013**

# Përmbajta

Lista e Shkurtesave	6
---------------------	---

## KAPITULLI I

Informacione të Përgjithshme rreth Kompanisë	8
Fjala e Kryetarit të Bordit të Drejtorëve	11
Fjala e Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT	12
Sistemi i Transmisionit të Republikës së Kosovës	14
Qeverisja Korporative	16
Aspektet Ligjore dhe Rregullative	18

## KAPITULLI II

Operimi i Rrjetit të Transmisionit të Kosovës dhe Investimet	20
Performanca e Sistemit	22
Humbjet në Rrjetin Transmetues	24
Konsumi dhe Ngarkesa Maksimale (PIKU)	26
Sistemi i Transmisionit të Republikës së Kosovës	26
Politikat Mjedisore dhe Ndikimi i Veprimtarisë së KOSTT në Mjedis	34
Zhvillimi i Infrastrukturës së Transmisionit gjatë Vitit 2013 dhe Investimet	35
Zhvillimi i Kapaciteteve të Sistemit të Transmisionit gjatë vitit 2013	36
Përgatitjet për Investime dhe Investimet e Rëndësishme të realizuara gjatë vitit 2013	37

## KAPITULLI III


Operimi e Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës	40
Implementimi i Platformës së Teknologjisë së Informacionit (TI) për Operim të Tregut	43
Jo-balancet e Sistemit	43
Bashkëpunimi dhe Integrimi i KOSTT në Asociacionet dhe Mekanizmat Regjional	44

## KAPITULLI IV

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	46
Zhvillimi dhe Trajnimi i Punonjësve	49
Implementimi i Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë dhe Planet për Sistemin e Integruar	49


## KAPITULLI V

Pasqyrat Financiare të Audituara dhe Raporti i Auditorit	50
Ngjarjet Gjatë vitit 2013	59
Indeksi i Tabelave	62
Indeksi i Figurave	63



## Lista e Shkurtesave

<b>ATR</b>	Autotransformator
<b>BERZH</b>	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
<b>BtD</b>	Bordi i Drejtorëve
<b>CAO</b>	Coordinated Auction Office/Zyra për Alokim dhe Koordinim të Kapaciteteve
<b>CCTV</b>	Closed Circuit Television/ Video Kamerat Vëzhguese
<b>CMMI</b>	Congestion Management and Market Integration/ Menaxhimi i Kongjestionëve dhe Integrimi i Tregut
<b>ECS</b>	Energy Community Secretariat/ Sekretariati i Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore
<b>EJL</b>	Evropa Juglindore
<b>EMS</b>	Elektromreza Srbije/OST e Serbisë
<b>GWh</b>	Gigavat orë
<b>HC</b>	Hydrocentral
<b>KE</b>	Kryeshf Ekzekutiv
<b>KEDS</b>	Kompania Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike
<b>KEK</b>	Korporata Energjetike e Kosovës
<b>KfW</b>	Banka Gjermane për Zhvillim
<b>Km</b>	Kilometër
<b>KOSTT</b>	Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu
<b>kV</b>	Kilovolt
<b>LFC</b>	Load Frequency Control/ Rregullimi i Ngarkesës dhe Frekuencës
<b>LP</b>	Largpërçues
<b>MVA</b>	Megavolt Amper
<b>MW</b>	Megawat
<b>NJPMNP</b>	Njësia për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike
<b>NP</b>	Ndërmarrje Publike
<b>NS</b>	Nënstacion



<b>NTC</b>	Net Transfer Capacity/ Kapaciteti Neto i Transferit
<b>OST</b>	Operatori Sistemit të Transmisionit
<b>OT</b>	Operator i Tregut
<b>PK</b>	Pa Kualifikim
<b>PL</b>	Përgatitje e Lartë
<b>PMP</b>	Përgatitje e Mesme Profesionale
<b>PSP</b>	Përgatitje Superiore Profesionale
<b>PU</b>	Përgatitje e Ulët
<b>RG SEE</b>	Grup rajonal nën ombrellën e MC/Komiteti i tregut i cili merret me çështjet EJL
<b>RrT</b>	Rregullat e Tregut
<b>SCADA/EMS</b>	Supervisory Control and Data Acquisition/ Energy Management System/ Mbikëqyrja, kontrolli dhe grumbullimi i të dhënave/ Sistemi për menaxhim të energjisë
<b>SECI</b>	Southeast Europe Cooperation Initiative Transmission System Planning Project/ Projekti i Planifikimit të Bashkëpunimit të Sistemit të Transmisionit në Evropën Juglindore
<b>SEE CAO</b>	Zyra për Alokim të Koordinuar të Kapaciteteve Interkonektive në EJL
<b>SG CMMI</b>	Nëngrupi për Menaxhimin e Kongjestionëve dhe Integrimin e Tregut
<b>SMC</b>	Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë
<b>SMM</b>	Sistemi i Menaxhimit Mjedisorë
<b>Sn</b>	Fuqia e Dukshme Nominale
<b>TC</b>	Termocentral
<b>TI</b>	Teknologjia Informativë
<b>TL</b>	Tension i Lartë
<b>TNOUS</b>	Ngarkesat për Shfrytëzimin e Rrjetit të Transmisionit
<b>TR</b>	Transformatorë
<b>ZRrE</b>	Zyra e Rregullatorit të Energjisë

# KAPITULLI I

## Informacione të Përgjithshme rreth Kompanisë





**Emri i regjistruar:** Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu-KOSTT sh.a

**Adresa e regjistruar:** Rr.Illjaz Kodra pn. 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

**Data e themelimit:** 1 Korrik 2006

**Numri i regjistrimit të biznesit:** 70325350

**Pronari i aksioneve:** Republika e Kosovës, përmes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik

**Licencat nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë:**

Licenca për Operim të Sistemit të Transmisionit

Licenca për Operim të Tregut të Energjisë Elektrike

**Kryeshf Ekzekutiv:**

- Naim Bejtullahu, nga data 21 Maj 2013
- Fadil Ismajli, deri më 21 maj 2013

**Kryesues i Bordit të Drejtorëve:** Ramadan Paçarada u.d

**Bordi i Drejtorëve:**

- Nazmi Mikullovc
- Lutfi Maxhuni
- Fatos Ukaj
- Faton Deda

## MISIONI

Misioni i KOSTT-it është që të sigurojë:

- *Shërbime kualitative duke implementuar arritjet tekniko teknologjike në zhvillimin e sistemit të transmisionit;*
- *Transparencë dhe jodiskriminim për shfrytëzuesit e sistemit të transmisionit në tregun konkurrues të energjisë elektrike;*
- *Avansimi i pozitës së kompanisë në nivel ndërkombëtar përmes aktiviteteve të shtuara në këtë drejtim*

## VIZIONI

“Të ofrojë shërbime të sigurta dhe të besueshme për shfrytëzuesit e sistemit të transmisionit, e përgjegjshme në aspektin social dhe mjedisor, e integruar në mekanizmat evropianë të transmisionit të energjisë elektrike, duke qenë njëkohësisht edhe fitimprurëse”.





## Ramadan Paçarada

U.d. Kryesues i Bordit të Drejtorëve të KOSTT sh.a.

### FJALAE KRYETARIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

Gjatë vitit 2013 KOSTT ka vazhduar performancën pozitive të afarizmit e cila është karakterizuar me zhvillime të shumta, si në aspektin zhvillimor ashtu edhe në çështjet e integriteteve regjionale.

Sa i përket zhvillimit të infrastrukturës së transmisionit KOSTT tanimë ka kaluar tërësisht në vetëfinancim dhe gjatë vitit 2013 është nënshkruar kredia e dytë me Bankën zhvillimore gjermane KfW për financimin e projekteve në rrjet. Për më tepër, janë iniciuar bisedat me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) për financimin e projekteve investive gjatë periudhës së ardhshme.

Në anën tjetër KOSTT ka vazhduar angazhimin për integrimin në mekanizmat dhe proceset regjionale, si angazhimin për themelimin e

Zyrës për Alokim të Koordinuar të kapaciteteve interkonektive në Evropën Juglindore, dhe përgatitjen e infrastrukturës për t'i plotësuar kriteret për anëtarim në ENTSO-E.

Një ndër projektet të cilat vlen të theksohet është edhe projekti i rëndësisë së veçantë për Republikën e Kosovës – Linja interkonektive 400kV Kosovë – Shqipëri dhe projekti i Rregullimit Frekuencë – Fuqi, e të cilat do mundësojnë shkëmbim më të madh të energjisë me Republikën e Shqipërisë dhe rajonin, si dhe optimizmi i operimit të sistemit.

Bordi i Drejtorëve të KOSTT në funksion të përmbushjes së detyrave të veta në vazhdimësi ka monitoruar zhvillimet në kompani duke i krahasuar ato me objektivat e përcaktuara me Planin e

Biznesit dhe dokumentet tjera. Kontribut të rëndësishëm lidhur me këtë kanë dhënë edhe komisionet funksionale të Bordit të Drejtorëve të cilat për së afërmi kanë përcjellur zhvillimet në lëmi të caktuara dhe kanë ofruar rekomandimet dhe mbështetjen e vet lidhur me këto procese.

Në përmbyllje, edhe aspekti financiar i afarizmit ka treguar rezultate të kënaqshme gjatë vitit 2013, ku vlen të përmendet se KOSTT ka deklaruar dhe paguar dividendë për aksionarin në vlerë prej 3 milion euro.

Bordi i Drejtorëve mbetet i zotuar dhe fuqishëm beson se sukseset e KOSTT nuk do të mungojnë as në vitin 2014 dhe shpreh mirënjohjen për të gjithë punonjësit dhe menaxhmentin e KOSTT sh.a.



## Naim Bejtullahu

Kryeshf Ekzekutiv

### FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV TË KOSTT SH.A

KOSTT edhe gjatë vitit 2013 ka vazhduar rrugëtimin në konsolidimin e infrastrukturës së transmissiionit dhe angazhimeve për zhvillimin e platformës për të mundësuar integrimin në mekanizmat rajonal dhe evropian, duke implementuar projekte dhe iniciativa për të garantuar siguri të furnizimit dhe shërbime kualitative për shfrytëzuesit e sistemit të transmissiionit.

Në periudhën e kaluar janë ndërmarrë shumë aktivitete në përfundimin e projekteve në vazhdim, si dhe fillimin e implementimit të projektit për Linjën interkonektive 400kV Kosovë – Shqipëri dhe projektin e Rregullimit Frekuencë – Fuqi, të cilat ndjeshëm do të kontribuojë në optimizimin e sistemeve të të dy vendeve dhe zhvillimit ekonomik. Të dy këto projekte në vitin 2013 janë kontraktuar për zbatim.

Implementimi i suksesshëm i projekteve kapitale, do të ndihmojë në përmbushjen e objektivave themelore të vendosura nga KOSTT, të cilat janë në pajtueshmëri të plotë me kërkesat teknike që dalin nga aktetet e ENTSO-E. Marrëveshjet për operim me Serbinë dhe Maqedoninë janë negociuar në vitin 2013 dhe priten të firmosen në kuartalin e parë të vitit 2014 dhe kështu kompletohen marrëveshjet e interkonjeksionit me shtetet fqinje (marrëveshjet me Shqipërinë dhe Malin e Zi janë nënshkruar më heret). Marrëveshja me Serbinë për energji e firmosur në mes të Kryeministrave të Kosovës dhe Serbisë e promovon KOSTT si operator i njohur ndërkombtarisht që sanksionohet me Marrëveshtjen për Operim.

Performanca e operimit të sistemit të transmissiionit në vitin 2013 është mjaft e mirë dhe tregon përmirësime të vazhdueshme krahasuar me vitin paraprak. Linjat dhe nënsta-

cionet janë mirëmbajtur sipas planit të paraparë, janë realizuar kontrollimet/inspektimet e nënstacioneve dhe linjave, janë realizuar remontet e rregullta vjetore të fushave nëpër NS dhe janë bërë energjizimet e NS-ve, duke përfshirë komisionimin dhe testimin e mbrojtjeve rele, si dhe implementimin e projekteve të rëndësishme.

Funksionet operative në monitorimin dhe veçmas në operimin e sistemit në kohën reale, janë avansuar, ndërsa Sistemi infrastrukturor SCADA\EMS i Telekomit dhe Matjeve komerciale ofrojnë mundësi shumë më të avansuara për operim të sigurisë së lartë.

Gjatë vitit 2013, KOSTT ka punuar në zhvillimin e strategjisë për hyrje në tregun e telekomunikimeve, duke ofruar tepricën e kapaciteteve fiber optike. Në këtë drejtim, Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it, mori vendimin për inicimin e aktiviteteteve për aplikim për

autorizim/licencë për Operator të shërbimeve të infrastrukturës në tregun e telekomunikimeve, kërkesë kjo e cila është aprovuar nga ana e Autoritetit Rregullativ të Telekomunikimeve Elektronike e Postare (ARKEP) të Kosovës.

Edhe për vitin 2012, për të shtatën herë radhazi, raporti i auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare është pa asnjë kualifikim, që reflekton punën profesionale dhe përkushtimin e KOSTT në zbatimin e standardeve më të larta në proceset e punës dhe përmbylljen me shumë sukses të shfrytëzimit të të gjitha resurseve të KOSTT.

Përqëndrimi i KOSTT gjatë periudhës së ardhshme do të jetë i orientuar në sigurimin e qëndrueshmërisë afariste dhe zhvillimin e shkathësive të punonjësve të KOSTT, të cilët janë forca shtytëse për zhvillimin e kompanisë dhe të vendit.

# SISTEMI I TRANSMISIONIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS




Fig 1 Harta e Sistemit të Transmisionit të Kosovës, 31.12.2013



## QEVERISJA KORPORATIVE

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2013 KOSTT ka zhvilluar aktivitete të ndryshme të qeverisjes korporative bazuar në Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (NP). Aktivitetet kryesore në këtë aspekt përfshijnë aktivitetet e Bordit të Drejtorëve, Komisionit të Auditimit dhe Komisioneve të tjera që Bordi i ka themeluar për nevojat e KOSTT.


Me 13 mars 2013 Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerrë vendimin numër 01/119 me të cilin KOSTT përcaktohet si Kompani Publike e kategorisë së parë.

Procesverbalet nga mbledhjet e Bordit, të Komisionit të Auditimit dhe të Komisioneve të tjera, raportimi dhe dërgimi i infomatave Njesisë së Monitorimit të Ndërmarrjeve Publike (NJPMNP) siç kërkohen sipas nenit 31, 32 dhe 37 të Ligjit për NP, janë kryer në mënyrë të rregullt dhe sipas afateve ligjore. Gjatë vitit 2013 Bordi i Drejtorëve të KOSTT ka mbajtur gjithësej 12 mbledhje të rregullta dhe 2 mbledhje të jashtëzakonshme, si dhe mbledhjen e përgjithshme vjetore me aksionarin.

Çdo mbledhje e rregullt e Bordit ka trajtuar disa pika që paraqiten si pika të zakonshme dhe përfshijnë: Vërtetimin e kuorumit dhe aprovimin e rendit të ditës, miratimin e procesverbalit nga mbledhja paraprake e Bordit të Drejtorëve, Shqyrtimin e Raportit të Komisionit të Auditimit dhe Komisioneve të tjera dhe Informatën rreth aktiviteteve nga Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv (KE) të KOSTT.

Në çdo mbledhje Bordi ka shqyrtuar dhe aprovuar raportin e Komisionit të auditimit dhe rekomandimet, si dhe raportet e Komisioneve të përkohshme siç janë: Komisioni për investime kapitale, Komisioni për shqyrtimin e operimit, dhe Komisioni për legjislacion dhe përcjelljen e kontesteve ligjore.

Raportet nga mbledhjet e Komisionit të Auditimit dhe Komisioneve të themeluara nga Bordi janë prezantuar si materiale në mbledhjet e Bordit dhe janë dërguar në NJPMNP.



*Në tabelën më poshtë janë paraqitur vendimet kryesore që janë aprovuar nga Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2013 duke mos i përfshirë mbledhjet dhe konsultimet e Zyrtarëve të Kompanisë, respektivisht Kryeshefit Ekzekutiv, Zyrtarit Kryesor Financiar, Sekretarit të Kompanisë dhe Auditorit të Brendshëm me Bordin dhe Zyrtarët e Njesisë së Monitorimit të Ndërmarrjeve Publike, raportimet dhe aktivitetet e ngjashme korporative.*



Nr.	Vendimet e Bordit për aprovimin e dokumenteve si vijon:
1	Raport tremujor për periudhën Tetor –Dhjetor 2012 Raport tremujor për periudhën Janar – Mars 2013 Raport tremujor për periudhën Prill-Qershor 2013 dhe Raport tremujor për periudhën Korrik-Shtator 2013 (bazuar në nenin 31 të Ligjit për NP)
2	Raporti i Komisionit për regjistrimin e pasurisë të KOSTT-it për vitin 2012 (Elaborati i regjistrimit të asetëve)
3	Plani i Biznesit 2013-2017
4	Plani Investiv 2013-2017
5	Plani Zhvillmor i Transmisionit 2013-2022
6	Plani i punës së Bordit të Drejtorëve (BtD) dhe Komisionit të Auditimit për vitin 2013
7	Raporti Vjetor i punës së KOSTT-it për vitin 2012
8	Marrëveshja për Kredi me KfW
9	Marrëveshja për Kredi me BERZh
10	Politika për Arkivën
11	Raporti i Auditorit të Jashtëm për Pasqyrat Financiare Rregullative për vitin 2012
12	Plani i Biznesit i reviduar për vitin 2013
13	Manuali për Vlerësimin e Rrezikut në vendin e punës
14	Plani i Prokurimit për vitin 2014
15	Vendimi për Emërimin e Kryeshefit Ekzekutiv

**Tab 1** Vendimet e Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2013



## ASPEKTET LIGJORE DHE RREGULLATIVE

KOSTT operon në përputhje me kornizën rregullative primare (Ligjit për Energjinë, Ligjit për Energjinë Elektrike dhe Ligjit për Rregullatorin e Energjisë) si dhe legjislacionit sekondar (Licencat, Kodet Teknike, Rregullat, Udhëzimet Administrative etj).

KOSTT edhe gjatë vitit 2013 ka vazhduar me punën dhe kontributin në zhvillimin e kornizës rregullative në pajtueshmëri me ato të Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore (EJL) si dhe me Pakon e Tretë të energjisë të Bashkimit Evropian.

Gjatë vitit 2013, kanë vazhduar aktivitetet për amendamentimin dhe finalizimin e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, të cilat janë përgatitur mbi bazën e Dizajnit të Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës dhe Mekanizmit Balancues. Deri në finalizimin e Rregullave të Tregut, KOSTT ka konsultuar palët e interesit duke përfshirë edhe Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për EJL.

Pas Vendimit të Qeverisë nr. 10/29 sipas të cilit asetet 400/220/110 kV janë në pronësi të KOSTT sh.a, duke përfshirë edhe transformatorët 220/35/10 (20) kV dhe 110/x kV si dhe fushat përkatëse me ndërprerësin e transformatorëve 35 kV dhe 10 (20) kV, janë harmonizuar Kodi i Rrjetit dhe Kodi i Pajisjeve Elektrike si dhe Standardet e Sigurisë së Operimit dhe Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Transmisionit.

Në pamundësi të zbatimit të disa dispozitave të Licencës së OST, Kodit të Rrjetit dhe dispozitave të Kodit të Matjes, KOSTT ka kërkuar nga ZRrE derogim (shtyrje e afatit) të përmbushjes së disa dispozitave për periudha të caktuara kohore.

Dokumentet të cilat janë përgatitur dhe amendamentuar nga KOSTT dhe janë aprovuar nga ZRrE gjatë vitit 2013 janë:

- 1) Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës
- 2) Rregullat e Tregut (ver. 2.0)
- 3) Metodologjia e Ngarkesave për Shfrytëzimin e Rrjetit të Transmisionit (TNUOS)
- 4) Metodologjia e Ngarkesave të Operatorit të Sistemit
- 5) Metodologjia e Ngarkesave të Operatorit të Tregut
- 6) Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmisionit (ver 2.7)
- 7) Kodi i Rrjetit (ver. 2.2)
- 8) Kodi i Pajisjeve Elektrike (ver. 2.2)

Gjithashtu, janë aprovuar edhe:

- 1) Plani Zhvillimor i Transmisionit 2014 - 2023
- 2) Balanca Vjetore e Energjisë Elektrike 2014





## KAPITULLI II

# Operimi i Rrjetit të Transmisionit të Kosovës dhe Investimet

KOSTT sh.a operon me Sistemin e Transmisionit të Republikës së Kosovës duke krijuar kushtet që në mënyrë të sigurtë dhe të besueshme të transmetohet energjia elektrike nga njesitë e gjenerimit deri te sistemi i shpërndarjes 24 orë në ditë, 365 ditë në vit.

KOSTT menaxhon Sistemin e Transmisionit duke operuar me nivelet e tensionit të lartë 400 kV, 220 kV 110 kV dhe tensionit të mesëm 35 kV, 20(10) kV. Kosova ka lidhje interkonektive me të gjitha shtetet fqinje:

- *Maqedoninë – 1 linjë 400 kV*
- *Malin e Zi – 1 linjë 400 kV*
- *Serbinë – 1 linjë 400 kV, 1 linjë 220 kV dhe 2 linja 110 kV*
- *Shqipërinë – 1 linjë 220 kV*

Në proces është ndërtimi i linjës interkonektive 400 kV me Shqipërinë.

Në tabelën e mëposhtme janë prezentuar të dhënat sipas bilancit të realizuar.

	MWh		2012	2013	2013/ 2012 (%)
<b>Gjenerimi</b>	<b>Hidro Gjenerimi (Neto)</b>	<b>(H)</b>	<b>64 873</b>	<b>99 387</b>	<b>153.20</b>
	HC Lumbardhi		22 901	29 707	129.72
	HC UJMANI		64 873	99 387	153.20
	<b>Termo Gjenerimi (Neto)</b>	<b>(T)</b>	<b>5 383 975</b>	<b>5 877 485</b>	<b>109.17</b>
	TC Kosova A		1 948 517	2 014 046	103.36
	TC Kosova B		3 435 458	3 863 439	112.46
	<b>Total Gjenerimi (Neto)</b>	<b>2 = (H) + (T)</b>	<b>5 448 848</b>	<b>5 976 872</b>	<b>109.69</b>
<b>Shkëmbimet</b>	Total Rrjedhat fizike Dërgim ( + )	(D)	2 619 466	2 893 304	110.45
	Total Rrjedhat fizike Marrje ( - )	(M)	2 773 062	2 551 216	92.00
	<b>Total Neto Balanci i Shkëmbimeve</b>	<b>3 = (D) - ( M)</b>	<b>- 153 596</b>	<b>342 089</b>	
<b>KOSTT</b>	Hyrjet në transmision	4=(2+M)	8 221 910	8 528 088	103.72
	Humbjet në Transmision	5	108 512	110 336	101.68
	Humbjet në Transmision (%)	5/ 4 *100	1.32	1.29	98.03
	<b>Energjia e dërguar nga Transmisioni (1)</b>	<b>6=(2-3-5)</b>	<b>5 493 931</b>	<b>5 524 447</b>	<b>100.56</b>
	Energjia e dërguar nga Interkonekcioni	(D)	2 619 466	2 893 304	110.45
	Energjia dërguar Distribucionit	( a )	4 593 409	4 606 524	100.29
	Mihjet,konsumatorët e jashtëm të KEK dhe shpenzimet e gjenerimit nga transmisioni	( b ) ( c )	426 668	430 232	100.84
	Energjia Dërguar kons.direkt e të kualifik.	( d )	473 853	487 691	102.92
	New Co Ferronikeli		407 480	403 704	99.07
	Sharri		42 881	59 439	138.62
	Trepça		23 493	24 549	104.49
	<b>Barazimi (Settlements) në Dërgim</b>	<b>7=(a+b+c+d)</b>	<b>5 493 931</b>	<b>5 524 447</b>	<b>100.56</b>
	Total energjia e dërguar nga Transmisioni	8=7+D	8 113 398	8 417 752	103.75
	<b>Ngarkesa maksimale (MW)</b>		<b>1 168</b>	<b>1 101</b>	<b>94.26</b>
Kërkesa (Konsumi bruto) i Kosovës	10=(2-3)	5 602 443	5 634 784	100.58	

Prodhimi i HC Lumbardhi nuk përfshihet në gjenerimin total, pasi që nuk është i kyçur në rrjetin e transmisionit.

**Tab 2** Të dhënat sipas bilancit të realizuar

## PERFORMANCA E SISTEMIT

### Energjia e pafurnizuar

Në vitin 2013 ka pasur një rritje të lehtë të energjisë së pafurnizuar në Sistemin e Transmisionit të Kosovës në krahasim me vitin 2012. Rreth 75% e energjisë së pafurnizuar në Sistemin e Transmisionit në vitin 2013 ka qenë e planifikuar, me qëllim që të mundësohen punimet në kuadër të projekteve të KOSTT, si dhe si pasojë e implementimit të projektit të Qeverisë së Kosovës për ndërtimin e Autostradës Morinë-Merdar.


Nr	Indikatori		2012	2013	2013
			Janar-Dhjetor	Janar-Dhjetor	/2012 (%)
T1	Energjia e transmetuar (GWh)		8221.91	8528.09	103.72
T2	Piku koincident (MW)	me tranzit	1168	1101	94.26
		pa tranzit			
T3	Gjatësia totale e linjave (km)	400 kV	188.49	188.49	100.00
		220 kV	231.83	231.83	100.00
		110 kV	764.94	776.336	101.49
		Gjatësia e linjave 110kV është shtuar për 11.39km, kyçja e NS Lipjani në linjën 110 kV, nr. 112, përmes linjës së dyfishtë 110 kV			
T4	MVA-km	400 kV	248249	248249	100.00
		220 kV	77506	77506	100.00
		110 kV	83209	86592	104.07
T5	Kapaciteti i transformatorëve	400/220 kV 400/110 kV	1800	1800	100.00
		220-110 kV	1350	1350	100.00
		*(220/X,110/X/X) kV	1788.5	1788.5	100.00
T6	Kapaciteti i disponueshëm mesatar import/eksport (AATC)	I paaplikueshëm			
T7	Kapaciteti i disponueshëm maksimal import/eksport (MATC)	I paaplikueshëm			
T8	Pagesa për kongjestion	I paaplikueshëm			
T9	Koha mesatare e rënjes (AIT minuta/tremujor)		304.00	670.79	220.65
		AIT ka qenë më e madhe për periudhen Janar-Dhjetor 2013. Rreth 75% e energjisë së pafurnizuar ka qenë më plan, për shkak të ndërprerjeve gjatë implementimit të projekteve të KOSTT dhe për shkak të punimeve të autostrades.			
T10	Numri i ankesave për tension		1	3	
T11	Ankesat e zgjidhura për tension	Më pak se një javë	1	3	
		Më pak se një muaj			
		Më shumë se një muaj			

T12	Numri i ankesave për matje		0	0	
T13	Ankesat e zgjidhura për matje	Më pak se një javë	0	0	
		Më pak se një muaj			
		Më shumë se një muaj			
T14	Vlera mesatare absolute e devijimeve orare Programi (MWh/hour)	Import	33.94	28.94	85.25
		Eksport	30.71	30.25	98.50
T15	Humbjet në transmision (GWh)		108.51	110.34	101.68
		Humbjet e energjisë elektrike në transmision kanë qenë për 1,68 % më të mëdha në vitin 2013 krahasuar me atë të vitit 2012.			


**Tab 3** Indikatorët e performancës

Energjia e pafurnizuar dhe disponueshmëria e rrjetit të transmisionit për disa vite është paraqitur në fig.2.

### **Energjia e pafurnizuar (%) 2007-2013**




### **Disponueshmëria e rrjetit të transmisionit 2007-2013**



**Fig 2.** Energjia e pafurnizuar dhe disponueshmëria e rrjetit të transmisionit për disa vite

## HUMBJET NË RRJETIN TRANSMETUES

KOSTT që nga themelimi në vitin 2006, në mënyrë të vazhdueshme ka investuar në zhvillimin e rrjetit transmetues dhe mirëmbajtjen e aseteve, faktorë të cilët ndër të tjera kanë ndikuar që humbjet e energjisë elektrike në rrjet të përgjysmohen. Derisa në vitin 2006 humbjet ishin 3.78%, në vitin 2013 humbjet kanë qenë në nivelin 1.30%. Që nga themelimi i KOSTT në vitin 2006 me masat që janë ndërmarrë për zhvillimin e rrjetit transmetues, operimin me metodat optimale, si dhe mirëmbajtjen efektive të rrjetit, është ndikuar në rritjen e performancës së sistemit transmetues gjegjësisht zvogëlimin e humbjeve teknike në sistem. Humbjet në vitin 2013 kanë shënuar një ngritje të lehtë në sasi për 1.8 GWh, ndërsa zvogëlim në përqindje, krahasuar me vitin paraprak. Kjo vie si pasojë e ndryshimit të kufirit të transmisionit me distribucionin sipas vendimit të Qeverisë nr. 10/29. Megjithatë humbjet përsëri janë nën kufirin e lejuar nga ZRrE për 0.78%. Përqindja e humbjeve llogaritet në raport me energjinë e tërë e cila hyn në rrjetin e transmisionit, të dhëna të cilat janë paraqitur në fig.3.




**Fig 3.** Humbjet në Transmision 2006-2013






Ngarkesa maksimale gjatë viteve ka pësuar rritje, poashtu edhe konsumi, por në vitin 2012 dhe 2013 shihet një zvogëlim i konsumit për shkak që temperaturat gjatë sezonit dimëror kanë qenë më të larta krahasuar me vitin 2011. Ky trend shihet në Fig.4.



**Fig 4** Konsumi dhe piku 2000-2013

Ndërsa në Fig.5. është paraqitur konsumi mujor i Kosovës për vitet 2011-2013



**Fig 5** Konsumi bruto i Kosovës për vitet 2011-2013

## KONSUMI DHE NGARKESA MAKSIMALE (PIKU)




Fig 6 Lakorja e kohëzgjatjes së ngarkesës 2013

Në Fig.6 janë paraqitur vlerat e ngarkesave, duke i radhitur prej vlerës më të madhe e deri te vlera më e vogël e ngarkesës, të paraqitura në MW për të gjitha orët e vitit.

## SISTEMI I TRANSMISIONIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

KOSTT edhe gjatë vitit 2013 me qëllim të operimit të sistemit në mënyrë sa më të besueshme, të sigurtë dhe efikase ka vazhduar me praktikat më të mira dhe të reja të mirëmbajtjes së rrjetit transmetues. Në këtë mënyrë, vazhdon të ruhet dhe rritet performanca e aseteve dhe infrastrukturës së rrjetit.

Mirëmbajtja e Sistemit të Transmisionit të Kosovës, realizohet bazuar në politikën e mirëmbajtjes dhe procedurat, të cilat i përgjigjen pajisjeve në veçanti, bazuar në rekomandimet e prodhuesve dhe gjendjes së aseteve e cila vlerësohet gjatë inspektimeve apo remonteve. Në tabelën 4 janë paraqitur gjatësia totale e linjave të tensionit të lartë 110kV, 220kV dhe 400kV për vitin 2013 në Republikën e Kosovës dhe kapaciteti transmetues i këtyre linjave.

Linjat Ajrore	Gjatësia totale në Kosovë (km)	Kapaciteti transmetues $C_t = S_n * L$ [MVA km]
400 kV	188.497	248249
220 kV	231.882	77506
110 kV	791.3	88391


Tab 4 Gjatësia e linjave transmetuese dhe kapaciteti transmetues i tyre

Në tabelën 5 është paraqitur vjetërsia e largpërçuesve të KOSTT nga ku shihet që numër më i madh i linjave të tensionit 400kV dhe 110kV janë më të vjetra.


Numri	Mosha (vite)	Niveli 400kV	Niveli 220kV	Niveli 110kV
1	0-25	0	0	18%
2	25-35	28%	77%	22%
3	35-50	72%	23%	60%

**Tab 5** Vjetërsia e linjave të rrjetit të KOSTT për vitin 2013

Në figurën 7 është paraqitur mosha e largpërçuesve në përqindje varësisht nga niveli i tensionit. Nga kjo figurë shihet se largpërçues të rinj kemi vetëm të nivelit 110kV ku rreth 18% e largpërçuesve të këtij niveli janë më të rinj se 25 vjet. Largpërçuesit e tensionit 220kV janë kryesisht të moshës 25-35 vjet, derisa numri më i madh i largpërçuesve 400kV janë të moshës 35-50 vjet.



**Fig 7** Mosha e linjave të shprehur në përqindje



Në tabelën 6 është paraqitur numri i nënstacioneve, sipas niveleve të tensionit. Nga kjo tabelë, shihet që numri i përgjithshëm i nënstacioneve në KOSTT, është 35.

Tensioni	Total
110/10(20)kV	7
110/10kV	8
110/35/10kV	3
110/35kV	9
220/110kV	3
220/35/10kV	1
220kV	1
400/110kV	2
400/220kV	1
<b>Totali</b>	<b>35</b>

**Tab 6** Numri i nënstacioneve ne bazë të auto transformatorëve të KOSTT për vitin 2013

Në tabelën 7, janë paraqitur auto transformatorët dhe nënstacionet ku ata ndodhen. NS Kosova B është nënstacioni kryesor dhe me më së shumti fuqi transformuese.

Auto transformatorët	Nr. i Auto transformatorëve	Kapaciteti total (MVA)
400/220/110kV	5	Total 1800MVA
NS Kosova B 400/220kV	3	3x400=1200MVA
NS Peja 3 400/110kV	1	1x300=300MVA
NS Ferizaj 2 400/110kV	1	1x300=300MVA
220/110kV	9	Total 1350MVA
NS Kosova A	3	3x150=450MVA
NS Prishtina 4	3	3x150=450MVA
NS Prizreni 2	3	3x150=450MVA

**Tab 7** Kapacitetet transformuese të auto transformatorëve të KOSTT për vitin 2013

Në tabelën 8 janë paraqitur kapacitetet transformuese të transformatorëve në pronësi të KOSTT për vitin 2013. Kapaciteti transformues nuk ka ndryshuar nga viti 2012.

Transformatorët	Nr. i transformatorëve	Kapaciteti total (MVA)
110/10.5(21)kV	26	877.4
110/36.75kV	2	63
110/36.75/10.5kV	22	341
110/36.75/6.6	1	63
220/10.5(21)kV	1	40
220/36.75/10.5(21)kV	1	40
<b>Totali</b>	<b>53</b>	<b>1824.4</b>


**Tab 8** Kapacitetet e instaluara transformuese te transformatorëve te KOSTT per vitin 2013

Në tabelën 9 janë paraqitur linjat interkonektive me shtetet fqinje dhe fuqia bartëse e tyre. KOSTT posedon gjithsej 7 linja interkonektive nga të cilat 3 të nivelit 400kV, 2 të nivelit 220kV dhe 2 të nivelit 110kV.


Linja	Tensioni (kV)	Fuqia natyrore (MVA)	NTC Sn	(MVA)
LP 407 NS Kosova B NS Nish	400	500	500	1317
LP 437/2 NS Peja 3 NS Ribarevina	400	500	400	1317
LP 420/2 NS Ferizaj 2 NS Shkupi 5	400	500	400	1317
LP2303 NS Prizreni 2 NS Fierza	220	120	210	300
LP 205/2 NS Podujeva NS Krushevc	220	120	100	300
LP 155/2 NS Vallaç NS Novi Pazar	110	31	N/A	83
LP1140/2 NS Berivojcë NS Bujanovc	110	31	N/A	83

**Tab 9** Kapacitetet e interkoneksionit për vitin 2013

Në figurën 8 janë paraqitur asetet e KOSTT gjatë vitit 2013 në bazë të nivelit të tensionit. Autotransformatorët dhe transformatorët janë klasifikuar në bazë të nivelit të tensionit në anën primare.



**Fig 8** Numri i asetëve sipas nivelit të tensionit për vitin 2013




**Fig 9** Krahasimi i numrit të asetëve të rrjetit të KOSTT për vitet 2012 dhe 2013

Ndryshimi i numrit të fushave të paraqitur në figurën 9 në nivelin 220kV nga viti 2012 në vitin 2013 ka ndodhur me vendosjen në punë të AT3 në NS Prizreni 2 dhe përfshirjen e fushave të gjeneratorëve në NS Kosova A.


Ndryshimi i numrit të fushave në nivelin 110kV ka ndodh me investimet që janë kryer në rrjet si: NS Gjilani 5 me 5 fusha, NS Prishtina 7 me 2, ndryshimi i skemës në NS Gjakova 1 nga 3 fusha në 7 fusha, shtimi i 2 fushave në NS Lipjani dhe 2 fushave në NS Prizreni 2.

Në anën 35kV dhe 10kV janë të përfshira vetëm fushat në anën sekondare të transformatorëve.

Në figurat 10 dhe 11 është paraqitur realizimi i planit të mirëmbajtjes së largpërçuesve (LP) dhe Nënstacioneve (NS). Nga këto figura, shihet se aktivitetet që nuk kanë nevojë për shkyçje janë realizuar në tërësi, ndërsa remontet dhe shqyrtimet e fushave në disa raste nuk janë realizuar, për shkak të pamundësisë për shkyçje.




**Fig 10** Krahasimi në mes të planifikimit dhe realizimit të mirëmbajtjes për linja në vitin 2013




**Fig 11** Krahasimi në mes të planifikimit dhe realizimit të mirëmbajtjes për nënstatione në vitin 2013

Në figurën 12 është paraqitur numri i intervenimeve emergjente në nënstatione të KOSTT nga viti 2009 deri në vitin 2013. Vërehet një rënie e numrit të intervenimeve nga viti në vit. Vetëm në nënstationet e nivelit 110kV ka pasur ngritje të numrit të intervenimeve si pasojë e problemeve në pajisjet e tensionit të lartë.




**Fig 12** Krahasimi i intervenimeve emergjente në nënstatione për vitet 2009-2013

Në figurën 13 është paraqitur krahasimi i intervenimeve në LP prej vitit 2009-2013. Nga kjo figurë shihet se numri i intervenimeve emergjente ka rënë nga viti në vit. Linjat e tensionit 400kV nuk kanë pasur fare nevojë për intervenim gjatë dy viteve të fundit. Ndërsa te linjat e 220kV dhe 110kV ka pasur disa rënie me nevojë për intervenim. Problemet kryesore me të cilat është ballafaquar KOSTT gjatë vitit 2013 sa i përket largpërçuesve kanë qenë rrëzimi i shtyllave të LP 1806 dhe LP 2298.




**Fig 13** Krahasimi i intervenimeve në linja për vitet 2009-2013

Edhe rëniet kalimtare të LP dhe transformatorëve (TR) gjatë tri viteve të fundit kryesisht kanë pasur trend të zvogëlimit si rezultat i mirëmbajtjes dhe investimeve të vazhdueshme.




**Fig 14** Krahasimi i rënieve të LP për vitet 2011-2013






**Fig 15** Krahasimi i rënieve të ATR dhe TR për vitet 2011-2013

Gjatë vitit 2013 LP 400kV kanë qenë të disponueshëm rreth 97.14% të kohës, Linjat 220kV kanë qenë të disponueshme rreth 94.89%, si pasojë e rrëzimit të shtyllave të LP2298. LP e tensionit 110kV kanë pasur disponueshmëri prej 91.97%, si pasojë e projekteve të cilat janë zhvilluar gjatë vitit 2013 dhe rrëzimit të tri shtyllave të LP1806.



**Fig 16** Disponueshmëria e LP për vitin 2013



Në figurën 17 është paraqitur disponueshmëria e transformatorëve në të gjitha nivelet e tensionit. Autotransformatorët 400/220kV kanë qenë të disponueshëm 88.31%. AT3 në NS Kosova B ka qenë jashtë punës për pjesën më të madhe të vitit për shkak të nevojës për mirëmbajtje më të detajuar, duke e ulur disponueshmërinë totale të këtyre autotransformatorëve. Transformatorët e nivelit 110/35/10kV kanë disponueshmëri prej 80.77% si pasojë e projekteve që janë zhvilluar si dhe aktivizimit të dy transformatorëve në NS Palaj për shkak të bilancit energjetik.




Fig 17 Disponueshmëria e ATR dhe TR për vitin 2013

## POLITIKAT MJEDISORE DHE NDIKIMI I VEPRIMTARISË SË KOSTT NË MJEDIS

Një ndër objektivat e KOSTT është edhe përgjegjësia, mbrojtja dhe zhvillimi i mjedisit në kuadër të veprimtarisë operuese të KOSTT. Në mbështetje të një zhvillimi të qëndrueshëm, KOSTT në vitin 2013 ka ndërmarrë veprime të nevojshme në drejtim të avancimit të kësaj objektivë. Synimi aktual është certifikimi me normën ndërkombëtare ISO 14001: 2004, për Sistemin e Menaxhimit Mjedisor (SMM). Për këtë qëllim, është duke u hartuar dokumentacioni relevant i nevojshëm.

Në vitin 2013 është punuar në hartimin e këtyre dokumenteve përkrahëse:

- Projekti për vendosjen e Riciklimit të mbetjeve në KOSTT (letra, plastika, qelqi si filim). Bashkëpunim me nivelin Komunal.
- Projekti i menaxhimit dhe identifikimit të PCB dhe PCT në vajrat e Trafo-ve (transformatorëve) në Objektet Energjetike të KOSTT.
- Elaborati i parë për vajrat e transformatorëve në NS 110 kV, përfshirë marrja e mostrave, testimi i mostrave, aspektet mjedisore si dhe raporti i testeve.
- Vendosja dhe aplikimi i Procedurës për largim të Eternit (varrosja e tij) nga çatia e Ndërtesës Qendrore të KOSTT (me përbërje të azbestit).

## ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS SË TRANSMISIONIT GJATË VITIT 2013 DHE INVESTIMET

Zhvillimi i Sektorit të Energjisë Elektrike në Kosovë është i bazuar në strategjinë nacionale të energjisë si dhe objektivave strategjike të Bashkimit Evropian ku Kosova synon të bëhet pjesë e saj. Zhvillimi i Sistemit të Transmisionit si një ndër shtyllat kryesore të Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës mbështetet në planin 10 vjeçar zhvillimor dhe investiv, i cili përcakton listën e projekteve dhe dinamikën e zhvillimit të tyre sipas prioritetit.

Planifikimi dhe zhvillimi i duhur i Sistemit Transmetues konform kërkesave teknike që dalin nga ENTSO/E është themelor në zhvillimin e sektorit elektroenergjetik të Kosovës. Objektivat kryesore të zhvillimit dhe planifikimit të Sistemit të Transmisionit janë:

- *Siguria nacionale e furnizimit të qëndrueshëm afatgjatë me energji elektrike përmes rrjetit të transmisionit*
- *Promovimi i integritetit të tregut të energjisë në nivelin nacional dhe regjional, konkurrencës dhe transparencës.*
- *Promovimi i zhvillimit të kapaciteteve të reja gjeneruese konvencionale dhe të ripërtërishme*
- *Zhvillimi ekonomik i vendit*

Zhvillimi dhe planifikimi adekuat i Sistemit të Transmisionit është i ndërlidhur me përcaktimin e konfiguracionit optimal të rrjetit dhe sistemeve ndihmëse në relacion me rritjen e konsumit dhe planifikimin e gjenerimit për periudhën planifikuese, ashtu që të plotësohen kërkesat e furnizimit të konsumatorëve në mënyrë të sigurt dhe ekonomike. Sistemi i transmisionit konsiderohet si një sistem tejet kompleks dhe dinamik në të cilin kërkesa për energji elektrike është në kontinuitet e ndryshueshme dhe në rritje, gjenerimi, rrjedhat e fuqisë në interkoneksion në nivelin nacional dhe regjional vazhdimisht ndryshojnë. Për të akomoduar këto ndryshime, në rrjetin e transmisionit janë të nevojshme përforcime të duhura të cilat në domenin afatgjatë kohorë mundësojnë performancë dhe siguri të duhur të operimit të sistemit të transmisionit.

Në vazhdimësinë e aktiviteteve thelbësore në ngritjen e kapaciteteve, besueshmërisë dhe sigurisë së sistemit transmetues të kryera në KOSTT gjatë periudhës kohore vitit 2009-2012, edhe viti 2013 është përcjellë me dinamikë të lartë për realizimin e projekteve të filluara gjatë vitit 2011-2012 dhe projekteve të reja në pajtueshmëri me Planin Zhvillimor të Transmisionit (2012-2022) i aprovuar nga ZRrE.

Planifikimi dhe zhvillimi i infrastrukturës së Sistemit Transmetues është orientuar në katër kategori të ndryshme të zhvillimit të projekteve:

- *Rritja e kapaciteteve të Rrjetit Transmetues.*
- *Ri-vitalizimi i nënstacioneve dhe pajisjeve të tensionit të lartë.*
- *Sistemet mbështetëse në operim të rrjetit (SCADA/EMS, grupet matëse, shërbimet ndihmëse, modernizimi i mbrojtjeve rele etj)*
- *Përkrahja e ngarkesës dhe gjenerimit (aplikacionet e kyçjes në Rrjetin e Transmisionit).*


Investimet e realizuara gjatë vitit 2013 arrijnë shumën prej 8. mil Euro, kryesisht të financuara nga buxheti i KOSTT.

## ZHVILLIMI I KAPACITETEVE TË SISTEMIT TË TRANSMISIONIT GJATË VITIT 2013

Implementimi i projekteve në zhvillimin e infrastrukturës gjatë vitit 2013 është karakterizuar me dinamikë të lartë të aktiviteteve dhe është realizuar pa cenuar sigurinë e sistemit transmetues falë projekteve kryesore të kryera gjatë periudhës 2009-2012, siç është Paket Projekti Peja 3, Paket Projekti Ferizaj 2, autotransformatori i tretë 150 MVA, në NS Kosova A në NS Prishtina 4 dhe NS Prizreni 2, etj.

Kapaciteti i rrjetit të transmisionit për konsumin e brendshëm në fund të vitit 2013 është ngritur për 1.35% në krahasim me fillimin e vitit 2012, ndërsa kapaciteti i bazuar në kriterin N-1 ka mbetur i pandryshuar, mirëpo në vitin 2013 është eliminuar problemi i furnizimit radial i NS Lipjanit i cili tani furnizohet përmes tri linjave 110 kV. Gjatë regjimit të operimit të sistemit në ngarkesë maksimale, rënia e paplanifikuar e autotransformatorit të vetëm në NS Peja 3, 400/110 kV konsiderohet kritike pasi që shkakton mbingarkim të disa linjave 110 kV si dhe rënien kritike të nivelit të tensionit në disa nyje 110 kV të sistemit. Ky problem do të tejkalohet pas instalimit të autotransformatorit të dytë 300 MVA në NS Peja 3 i cili pritet të futet në operim në vitin 2016.

Krijimi i nyjeve të fuqishme 400 kV si NS Peja 3 dhe NS Ferizaj 2 dhe ndërtimi i linjave 110 kV dhe përforcimi i tyre ka ndikuar që në kondita normale të operimit të sistemit transmetues (në ngarkesë maksimale), niveli i tensioneve gjatë vitit 2013 të jetë në brezin e lejuar sipas Kodit të Rrjetit.



**Fig 18** Zhvillimi i kapaciteteve interne të rrjetit të transmisionit 2009-2013




Fig 19 Zhvillimi i kapaciteteve ndër vite

## PËRGATITJET PËR INVESTIME DHE INVESTIMET E RËNDËSISHME TË REALIZUARA GJATË VITIT 2013

Viti 2013 karakterizohet si viti ku investimet kapitale janë realizuar nga buxheti i KOSTT, derisa investimet e parapara me planin investiv nga donacionet nuk kanë filluar.

Gjatë vitit 2013 KOSTT ka investuar në projektet që janë vazhdimësi nga vitet paraprake 2011/2012

1. Paket Projekti SCADA/EMS dhe Telekom: LOT-1:SCADA/EMS;
2. Paket Projekti SCADA/EMS dhe Telekom: LOT-2: Telekom;
3. Ndërrimi i përcuesit, izolatorëve dhe paisjeve lidhëse në LP 125/2 dhe 125/3;
4. Kycja e NS Lipjanit në linjën LP 212 ( Kosova A - Ferizaj 2);
5. Rialokimi i linjës 110kV, nr.1806 NS Gjakova 1-Gjakova 2 dhe Rehabilitimi i Paisjeve të TL në NS Gjakova 1;
6. Rehabilitimi i pajisjeve të tensionit të lartë 110 kV në NS Gjilani 1 dhe NS Ferizaji 1;
7. Instalimi i dy fushave të reja të linjave 110 kV në NS Prizreni 2;

Realizimi i projekteve gjithnjë përcillet edhe me rrezikshmëri të cilat kryesisht përcillen në mos mundësinë e çasjes tek pajisjet përkatëse siç është rasti i linjës LP 125/3 - linja për Valaç. Për shkak të situatës politike në pjesën veriore të Kosovës ka qenë i pamundur realizimi. Vonesat në projekte i shkaktojnë edhe procedurat e shpronësimeve të tokave, kur është fjala e ndërtimit të linjave.

Fillimi i projekteve të reja gjatë vitit 2013 karakterizohet me projektet të cilat përfshijnë kryesisht rehabilitime, siguri të nënstacioneve dhe rritje të kapaciteteve transformuese. Më poshtë janë dhënë projektet të cilat kanë filluar në vitin 2013 dhe vazhdojnë në vitin 2014:


8. *Rehabilitimi i stabilimenteve të TL në NS Gjakova 2 dhe Prizreni 3;*
9. *Rehabilitimi i Shtyllave të LP.2298 220kV me Nr.24 dhe 25 dhe LP.1806 110kV me Nr.31 dhe 32;*
10. *Ndërtimi i rrethojës së re në NS 400/220 kV Kosova B, dhe instalimi i ndriçimit përgjatë saj*
11. *Instalimi i kamerave vëzhguese (CCTV) në NS Kosova B dhe Depo;*
12. *Furnizimi dhe Instalimi i Mbrojtjeve rele numerike në fushat Autotransformatorike në NS Kosova B;*
13. *Furnizim me transformator të fuqisë*

Projekte me rëndësi për të cilat janë arritur marrëveshjet për bashkëfinancim në mes të KOSTT dhe KfW dhe në fund të vitit 2013 janë nënshkruar kontratat e implementimit janë projektet:

14. *Shërbimet konsulente dhe ndërtimi i linjës 400 kV RKS - AL - LOT 1;*
15. *Shërbimet konsulente dhe ndërtimi i linjës 400 kV Fusha e TL dhe LFC - LOT 2;*

Gjatë vitit 2013 vlera e aseteve në KOSTT është rritur edhe për tri nënstacione të reja 110/10/20 kV të cilat pas përfundimit të afatit garantues, nga KEK (KEDS) janë bartur në KOSTT: NS Gjilani 5, NS Palaj, NS Prishtina 7, për të cilat u bë edhe pranim dorëzimi i dokumentacionit.







## KAPITULLI III

# Operimi i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës



Sipas Ligjit për Energjinë Elektrike dhe Licencës së Operatorit të Tregut (OT) KOSTT duhet të zhvillojë Rregullat e Tregut (RrT). Pas miratimit të Dizajnit të Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës në Mars të vitit 2013, Operatori i Tregut ka bërë modifikimin e Rregullave të Tregut për të krijuar kushte transparente dhe jo-diskriminuese të tregtimit me energji elektrike ndërmjet palëve në treg dhe në fund të dhjetorit të 2013 të njëjtat janë aprovuar nga ZRrE. Këto rregulla përcaktojnë mënyrën e tregtimit të energjisë me shumicë ndërmjet palëve tregtare. Sipas Rregullave të Tregut, Tregu i energjisë elektrike do të jetë treg bilateral, i bazuar në kontrata afatgjata bilaterale mes prodhuesve, furnizueseve dhe tregtarëve ndërkufitar dhe nominimit të kontratave një ditë para realizimit fizik të tregut të energjisë elektrike. Palët do të jenë përgjegjëse për jo-balancet e shkaktuara të energjisë elektrike. Rregullat gjithashtu mbulojnë tregtimin e kapaciteteve transmetuese ndërkufitare dhe alokimin e të drejtave fizike transmetuese palëve fituese.

Prodhimi, konsumi dhe vlerat e rrjedhave ndërkufitare të matura të energjisë elektrike vjetore për vitin 2013 në hyrje dhe në dalje të zonës tregtare të Kosovës janë paraqitur në fig.20.






Fig 20 Rrjedhat ndërkufitare, Prodhimi dhe Konsumi gjatë vitit 2013

Nga energjia që ka rrjedhur në rrjetin transmetues të Kosovës, 71.44% është nga prodhimi vendor , 22.60% transit, 5.96% import për nevoja të konsumit të Kosovës, 65.59% i është dedikuar konsumit të Kosovës, 10.50% ka qenë eksport nga prodhimi në Kosovë dhe rreth 1.30 % të saj kanë qenë humbje në rrjetin transmetues.




**Fig 21** Energjia e tregtuar në zonën tregtare të Kosovës gjatë vitit 2013

Krahasuar me vitin 2012 ku numri i palëve të regjistruara në treg ka pasur një rënie, në vitin 2013 është vërejtur një trend i lehtë rritjeje:



**Fig 22** Numri i palëve të regjistruara në treg gjatë 5 viteve

Në diagramin e mëposhtëm është paraqitur sasia e importit dhe eksportit për periudhën 2009-2013.



**Fig 23** Importi dhe Eksporti 2009-2013

Nga diagrami vërejmë se eksporti gjatë viteve 2009-2013 ka pasur rritje. Derisa në vitin 2011 krahasuar me 2010 rritja ka qenë 5.3% në vitin 2013 krahasuar me vitin paraprak kjo rritje ka qenë shumë më e madhe 81.2% .

Importi për periudhën 2009-2011 ka pasur tendencë rritjeje kurse në periudhën 2011-2013 ka pësuar ndryshim duke u zvogëluar.

## IMPLEMENTIMI I PLATFORMËS SË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT (TI) PËR OPERIM TË TREGUT

Operatori i Tregut në muajin maj të vitit 2013 ka lëshuar në operim platformën e TI së tregut në formë të testimit (dry – run). Në maj 2013 është organizuar trajnimi për palët e brendshme tregtare për mënyrën e re të nominimit të programeve fizike dhe kontraktuale një ditë para. Mënyra e re e nominimit të programeve ditore është në pajtim të plotë me rekomandimet e ENTSO-E që përdorë formatin XML të shkëmbimit të të dhënave.

## JO-BALANCET E SISTEMIT

Në diagramin e mëposhtëm janë paraqitur jobalancet e sistemit sipas orëve të vitit 2013. Vlerat paraqesin shumën kumulative vjetore të jo-balanceve të sistemit:




Fig 24 Paraqitja në MWh e jo-balanceve të sistemit për vitin 2013.

## BASHKËPUNIMI DHE INTEGRIMI I KOSTT NË ASOCIACIONET DHE MEKANIZMAT REGJIONAL

Një ndër objektivat e rëndësishme të KOSTT ndër vite ka qenë dhe është integrimi regjional. Përkundër angazhimeve të vazhdueshme në këtë drejtim, KOSTT vazhdon edhe më tutje të ballafaqohet me shumë pengesa drejt integrimit në mekanizmat regjionalë. Pas arritjes së Marrëveshjes për Energji mes Kosovës dhe Serbisë, në Shtator 2013, KOSTT dhe EMS kanë filluar negociatat për arritjen e marrëveshjes operative, si dy zona rregulluese, e cila do t'i hapë rrugë KOSTT të integrohet në të gjithë mekanizmat rajonalë. Pritet që marrëveshja të nënshkruhet gjatë vitit 2014


Edhe më tutje KOSTT gjatë vitit 2013 është:

1. Vëzhgues në RG SEE<sup>1</sup>
  - a. Vëzhgues në SG CMMI<sup>2</sup>
2. Themelues i kompanisë së Projektit për themelimin e CAO<sup>3</sup>

Kompania e Ekipit të projektit të CAO ka përfunduar detyrën me sukses dhe janë krijuar kushtet për themelimin e Zyrës për Alokimin e kapaciteteve transmetuese interkonektive (SEE CAO) e cila do të filloj punën në Janar 2014. Kontesti KOSTT- EMS- Ankesa e KOSTT e ngritur në Gusht të 2008 në Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë ndaj Serbisë si palë nënshkruese e Traktatit, që njihet si "Case-3/8", lidhur me mos përmbushjen (shkeljen) nga ana e Serbisë të obligimeve që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë (ECS) respektivisht neneve 3 dhe 6 të Rregullores 1228/2003 që kanë të bëjnë me kompensimin e transitit të energjisë elektrike dhe alokimin e kapaciteteve transmetuese interkonektive, me gjithë konkludimin nga ana e ECS nuk është zgjidhur ende.


1. RG SEE- është grup regjional në ombrellën e MC –Market Committee – Komiteti i tregut i ENTSO-E dhe i cili do të merret me çështjet e tregut në EJM  
 2. SG CMMI - Nëngrupi për menaxhimin e kongjestionëve dhe integrimin e tregut  
 3. CAO- zyra për alokim të koordinuar të kapaciteteve interkonektive në EJM me seli në Podgoricë, që duhet themeluar nga TSO-të e regjionit të 8-të dhe pritet të filloj me punë në fillim të vitit 2013





# KAPITULLI IV

## Menaxhimi i Burimeve Njerëzore



**Fig 25** Struktura Organizative e KOSTT

Në përmbushjen e objektivave dhe performancën e KOSTT, rol thelbësor kanë luajtur punonjësit. Vitin 2013 KOSTT e ka përmbyllur me 368 punonjës, që do të thotë se ka pasur një zvogëlim prej 1.6% krahasuar me vitin paraprak.

Nga numri i përgjithshëm i punonjësve 31.5% janë me përgatitje superiore profesionale (diplomë universitare). 26,08% të punonjësve janë inxhinier, kjo si rezultat i veprimtarisë së KOSTT si Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike. Natyra e veprimtarisë së KOSTT gjithashtu ka pasur ndikim edhe në strukturën gjinore të kompanisë ku 86.96% janë meshkuj ndërsa vetëm 13.04% femra. Moshë mesatare e të punësuarve në KOSTT është 48.49 vite. Lëndime në punë nuk ka pasur.




1. Numri i të punësuarve në KOSTT	Viti 2012		Viti 2013		% (zvogëlim)	
	374		368		1.60%	
2. Struktura e të punësuarve sipas gjinisë	Viti 2012			Viti 2013		
Meshkuj	326	87.17%	320	86.96%		
Femra	48	12.83%	48	13.04%		
3. Struktura kualifikuese e punonjësve	Viti 2012			Viti 2013		
PSP (përgatitje superiore profesionale)	M	83	22.19%	M	82	22.28%
	F	33	8.82%	F	34	9.23%
PL (përgatitje e lartë)	M	7	1.87%	M	7	1.90%
	F			F		
KL (kualifikim i lartë)	M	20	5.34%	M	18	4.89%
	F			F		
PMP (përgatitje e mesme profesionale)	M	215	57.48%	M	205	55.70%
	F	11	2.94%	F	9	2.44%
PU (përgatitje e ulët)	M	1	0.26%	M	1	0.27%
	F	4	1.07%	F	5	1.36%
4. Struktura sipas profesionit me PSP	Viti 2012			Viti 2013		
Inxhinier	94	25.13%	96	26.08%		
Ekonomist	18	4.81%	21	5.70%		
Jurist	6	1.60%	6	1.63%		
Fakulteti i Filologjisë/Gjuhë Shqipe	1	0.26%				
5. Moshë mesatare e të punësuarve	47.78 vite			48.49 vite		
6. Lëndime në punë						

**Tab 10** Struktura e të punësuarve në KOSTT

Angazhimi dhe energjia e punëtorëve në punë varen shumë nga shëndeti që gëzojnë, prandaj KOSTT ka ndërmarrë masa për të kontribuar në shëndetin e punëtorëve të saj.

Edhe në vitin 2013 ka vazhduar me implementimin e projektit për sigurimin shëndetësor për të gjithë punëtorët me mjetet buxhetore të kompanisë. Krahas kësaj, KOSTT gjithashtu vazhdon edhe me implementimin e kontrolleve sistematike periodike si masë preventive e cila e përfshinë një ekzaminim të përgjithshëm të shëndetit të punëtorëve krahas aktivitetit të tyre në punë.

Gjithashtu, KOSTT kontribuon në shëndetin e punëtorëve duke ju mundësuar sigurimin e sallave ku punëtorët tanë mund të zhvillojnë aktivitete të ndryshme sportive.





## ZHVILLIMI DHE TRAJNIMI I PUNONJËSVE

Për realizimin e misionit, vizionit dhe strategjisë, së kompanisë gjatë vitit 2013 ka ndërmarrë disa aktivitete në zhvillimin dhe aftësimin e personelit. Vlera e shpenzimeve për kurse, trajnime, pjesëmarrje në grupe punuese të Evropës Juglindore, publikime dhe literaturë profesionale gjatë vitit 2013 është 127,469.70 €

*Gjithsej në këto trajnime të fushave përkatëse dhe grupe punuese janë përfshirë **127** punëtorë dhe janë realizuar **438** ditë trajnime dhe pjesëmarrje në grupe punuese.*

Duke iu dhënë rendësi të posaçme KOSTT edhe këtë vit ka mundësuar trajnimin e punëtorëve për siguri në punë, trajnime në lëminë e sigurisë industriale, trajnime për përdorimin e pajisjeve testuese, për mbrojtje rele, çështje rregullative etj.

Për të ofruar mundësi për njohuri të reja KOSTT ka mundësuar vizita studimore si “Wind Integration Project Study Tour 2013”. Nga kjo vizitë, kanë rrjedhë njohuri të reja lidhur me Operimin e Sistemit të Transmisionit dhe lidhur me aplikimin e metodologjive të operimit dhe menaxhimit të Grupeve Balancuese. Është përfituar përvojë në mënyrën e integritetit të burimeve të ripertriteshme në rrjetin e transmisionit dhe distribucionit.

KOSTT ka mundësuar pjesëmarrjen në grupe punuese si SECI dhe “CMMI”-Congestion Management and Market Integration.

Edhe këtë vit KOSTT ka vazhduar me edukimin e vazhdueshëm dhe trajnimin e operatoreve si kërkesë nga rregullat e ENTSO-E si dhe detyrimet tjera nga POLICY nr 5 dhe POLICY nr 8. Pas këtij trajnime kompania ka arritur që të jetë në hap me kërkesat që dalin nga ENTSO-E rregullat, me një staf të përgatitur profesional dhe të certifikuar.

## IMPLEMENTIMI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË CILËSISË DHE PLANET PËR SISTEMIN E INTEGRUAR

Zbatimi Praktik i Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2008 si një detyrë komplekse, e cila përveç angazhimit të menaxhmentit, ka angazhuar një ekip më të gjerë të udhëhequr nga menaxheri i Cilësisë për përmirësimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë.

Në vitin e IV-të të zhvillimit të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë (SMC), KOSTT i është nënshtruar procesit të riçertifikimit. Sistemi është harmonizuar me të gjitha kërkesat e standardit ISO 9001:2008 dhe ka rezultuar me riçertifikim të kompanisë me standardin ISO 9001:2008 duke e shtrirë sistemin e menaxhimit të Cilësisë në të gjitha objektet dhe njesitë e KOSTT-it. Raporti i auditimit të jashtëm ka rezultuar në përputhje të plotë me kërkesat e standardit ISO 9001:2008.

# KAPITULLI V


## Pasqyrat Financiare të audituara dhe Raporti i Auditorit



Afarizmi i KOSTT sh.a po vazhdon me trend të ngritjes së vazhdueshme si nga aspekti teknik po ashtu edhe nga aspekti financiarë. Trendet financiare paraqiten përmes indikatorëve kyç financiar të cilët janë mbi caqet e vendosura me Planin e Biznesit dhe në raport me vitin paraprak, të paraqitur në tabelën vijuese:

Treguesit	I-XII 2012	I-XII 2013	Caku me planin e biznesit
<b>T1. Fitimi operativ marginal</b>	0.13	0.15	mbi zero.
<b>T2. Treguesi i likuiditetit</b>	3.71	4.21	më i madh se 1.
<b>T3. Treguesi i qarkullimit të kërkesave</b>	153 dite	31 dite	Caku: ≤ 90 dite
<b>T4. Treguesi i efektit të kapitalit të investuar (ROCE)</b>	2.02%	2.97%	Caku: > 0

**Tab 11** Caqet e vendosura me Planin e Biznesit



Të hyrat gjithsejt të Kompanisë për vitin 2013 janë realizuar në vlerë prej **24.01 milion**, të cilat krahasuar me vitin 2012 janë më të larta për **14,83 %**.

Të hyrat nga tarifa për vitin 2013 janë realizuar në vlerën 17.68 milion, që krahasuar me vitin 2012 janë më të larta **13.10 %**

Fitimi para tatimit në vitin 2013 është në vlerë **4,27 milion**.

Fitimi neto pas tatimit **3,56 milion**.

Të hyrat e realizuara janë përdorë për:

- Mbulimin e shpenzimeve operative të Kompanisë
- Financimin e shpenzimeve të investimeve
- Pagesën e dividendës

Shpenzimet për investime janë orientuar në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës dhe mirëmbajtjes investive, me synim të ngritjes së performancës teknike dhe financiare të Kompanisë.

Vlera neto e aseteve nga 114,7 milion në vitin 2012 është rritë në 126,9 milion në vitin 2013

Pasuria totale nga 146.9 milion në vitin 2012 është rritë në 156.9 milion në vitin 2013 Raporti i dorëzuar nga kompania audituese vlerëson se "Pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar si dhe performancën financiare të Kompanisë në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.



Tel: +381 381 221 173  
Fax: +381 38 221 176  
www.bdo.com

BDO Kosova L.L.C.  
Rr. Reshpa Lazi, nr.2  
10000 Prishtine, Kosova

## RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

Për bordin e drejtorëve të KOSTT SH.A.

Ne kemi qenë të angazhuar për auditimin e pasqyrave financiare shoqëruese të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut, Sistemit "KOSTT SH.A." (me tej referuar si "Kompania"), që përfshinë Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2013, Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2013, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.

### *Përgjegjësia e menaxhmentit për Pasqyrat Financiare*

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përfshinë: dizajnimin, implementimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm relevant për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare që janë të lira nga materiale, qoftë nga mashtrimi apo gabimi; përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura të kontabilitetit dhe bërjen e vlerësimeve të kontabilitetit që janë të arsyeshme për rrethanat.

### *Përgjegjësia e auditorit*

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në kryerjen e auditimit. Për shkak të çështjeve të përkrahura në paragrafin bazat për kualifikim të opinionit, ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe planifikojmë e kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë të lira nga ndonjë gabim material.

Auditimi përfshinë procedurat e kryerjes për të marrë dëshmi të auditimit lidhur me vlerat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen në gjykimin e auditorit, duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë nga ndonjë mashtrim ose gabim. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të riskut, auditori konsideron të përshtatshëm kontrollin e brendshëm për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të Kompanisë në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të duhura në rrethana, por jo për qëllim të shprehjes së një mendimi në efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Kompanisë. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e politikave të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga Menaxhmenti, gjithashtu edhe prezantimin e përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që dëshmitë e auditimit që ne kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinionin tonë të auditimit.

### *Opinionit*

Sipas mendimit tone, pasqyrat financiare të Kompanisë paraqesin drejtë, në të gjitha çështjet materiale pozicionin financiar të Kompanisë më 31 Dhjetor 2013 dhe performansën e saj financiare, ndryshimet në ekuitet dhe rrjedhën e parasë për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2013 në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

*BDO Kosova L.L.C.*  
BDO Kosova L.L.C.  
Prishtina, Kosova  
24 Mars 2014

BDO Kosova L.L.C. is a member of BDO Network Limited, a UK company limited by guarantee, and forms part of the international BDO network of independent member firms.  
BDO is the legal name for the BDO network and for each of the BDO Member Firms.

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT Sh.a.  
Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 Dhjetor 2013

	Shënim	Më 31 Dhjetor 2013 (në Euro 000)	Më 31 Dhjetor 2012 (në Euro 000)
<b>ASETET</b>			
<b>Asetet afatgjata</b>			
Prona dhe pajisjet	4	125,176	112,538
Asetet e paprekshme	5	1,695	2,155
		<u>126,871</u>	<u>114,693</u>
<b>Asetet afatshkurtra</b>			
Stoqet	6	2,594	1,838
Të arkëtueshmet	7	3,670	11,554
Kërkesa tjera	8	2,302	733
Paraja në dorë dhe në bankë	9	21,507	18,062
		<u>30,073</u>	<u>32,187</u>
<b>TOTAL ASETET</b>		<u>156,944</u>	<u>146,880</u>
<b>EKUITETI DHE OBLIGIMET</b>			
<b>Ekuiteti</b>			
Kapitali i pronarëve	10	25	25
Primi i aksioneve	11	53,172	38,322
Fitimet e mbajtura		15,157	15,368
Fitimi i vltit		3,557	2,789
		<u>71,911</u>	<u>56,504</u>
<b>Obligimet afatgjata</b>			
Grantet e shtyra	12	77,900	81,709
<b>Obligimet afatshkurtra</b>			
Obligimet tregtare dhe të tjera	13	7,133	8,667
		<u>85,033</u>	<u>90,376</u>
<b>TOTAL EKUITETI DHE OBLIGIMET</b>		<u>156,944</u>	<u>146,880</u>

Autorizuar nga menaxhmenti për botim dhe nënshkruar më 24 Mars 2014.

Naïm Bejtullahu

Nebih Haziri

  
Kryeshf Ekzekutiv

  
Zyrtari Kryesor Financiar

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri 23 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT Sh.a.  
 Pasqyra e të Hyrave Gjithëpërfshirëse për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2013

	Shënim	Për fund vitin 31 Dhjetor 2013 (në Euro 000)	Për fund vitin 31 Dhjetor 2012 (në Euro 000)
<b>Të hyrat operative</b>			
Transmisioni i energjisë	14	17,684	15,636
Të hyrat tjera operative	15	6,323	5,271
		<u>24,007</u>	<u>20,907</u>
<b>Minus: Shpenzimet operative</b>			
Shpenzimet e Stafit	16	(4,458)	(3,950)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	4-5	(9,547)	(8,769)
Riparimet dhe mirëmbajtja	17	(1,050)	(667)
Humbjet në transmision të energjisë		(3,427)	(3,433)
Shpenzimet tjera operative	18	(1,862)	(1,477)
Provizioni për dëmtim të inventarit		-	(106)
<b>Fitimi Operativ</b>		<u>3,663</u>	<u>2,505</u>
Të hyrat e Interesit		604	617
<b>Fitimi para tatimit</b>		<u>4,267</u>	<u>3,122</u>
Shpenzimet e tatimit	19	(710)	(333)
<b>FITIMI NETO PËR VITIN</b>		<u>3,557</u>	<u>2,789</u>
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse		14,850	9,975
<b>TOTALI I TË HYRAVE GJITHPËRFSHIRËSE PËR VITIN</b>		<u>18,407</u>	<u>12,764</u>

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri 23 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT Sh.a.  
Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2013

	Kapitali aksionar	Primi i aksioneve	Fitimet e mbajtura	TOTALI
	(në Euro 000)			
Bilanci më 1 Janar 2012	25	28,347	15,368	43,740
Neto fitimi për vitin 2012	-	-	2,789	2,789
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	-	9,975	-	9,975
<b>Bilanci më 31 Dhjetor 2012</b>	<b>25</b>	<b>38,322</b>	<b>18,157</b>	<b>56,504</b>
Bilanci më 1 Janar 2013	25	38,322	18,157	56,504
Neto fitimi për vitin 2013	-	-	3,557	3,557
Shpërndarja e dividendes	-	-	(3,000)	(3,000)
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	-	14,850	-	14,851
<b>Bilanci më 31 Dhjetor 2013</b>	<b>25</b>	<b>53,172</b>	<b>18,714</b>	<b>71,911</b>

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri 23 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT Sh.a.**  
**Pasqyra e të Rrjedhës së Parasë për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2013**

	Shënim	Për fund vitin 31 Dhjetor 2013 (në Euro 000)	Për fund vitin 31 Dhjetor 2012 (në Euro 000)
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</b>			
Fitimi para tatimit		4,267	3,122
Korrigjuar për:			
Zhvlerësimin dhe amortizimin	4-5	9,547	8,769
Të hyrat nga interesi	15	(604)	(617)
Neto shlyerjet e aseteve fikse	4	7	88
Provizioni për dëmtim të inventarit	6	-	106
Provizioni për të arkëtueshmet	7	-	-
Të hyrat shtyra nga grantet	12	(6,187)	(5,262)
Shpenzimi i tatimit në fitim	19	710	560
<b>Suficiti operativ para ndryshimeve në asete dhe obligime</b>		<b>7,740</b>	<b>6,766</b>
Rritja në inventar		(756)	(290)
Rritja në të arkëtueshmet		8,091	(3,964)
Zvogëlimi në kërkesa tjera		(1,659)	2,458
Rritja/(zvogëlimi) në të pagueshmet dhe obligime tjera		(1,534)	1,222
<b>Paraja e gjeneruar në operacione</b>		<b>11,882</b>	<b>6,192</b>
Tatimi në fitim i paguar		(710)	(495)
<b>Neto paraja e gjeneruar në operacione</b>		<b>11,172</b>	<b>5,697</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investive</b>			
Interesi i pranuar		604	617
Blerjet e aseteve fikse	4	(7,671)	(17,270)
Blerja e aseteve të paprekshme	5	(38)	(1,144)
<b>Neto paraja e përdorur në aktivitet investive</b>		<b>(7,105)</b>	<b>(17,797)</b>



<b>Rrjedha e parasë nga aktivitet financuese</b>		
Grantet e pranuar	2,378	11,557
Dividenda e shpërndarë	(3,000)	-
<b>Neto paraja e gjeneruar nga aktivitetet financuese</b>	<b>(622)</b>	<b>11,557</b>
<b>Neto rritja e parasë dhe ekuivalenteve të parasë</b>		
	<b>3,445</b>	<b>(543)</b>
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	18,062	18,605
<b>Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit</b>	<b>21,507</b>	<b>18,062</b>

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri 23 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Tab 15** Pasqyra e rrjedhës së parasë



# Ngjarjet gjatë vitit 2013

## JANAR

- Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRE), në mbledhjen e Bordit të mbajtur më 23 janar 2013, në bazë të kërkesës së KOSTT ka marrë vendim për aprovimin e Planit Zhvillimor të Transmisionit 2013-2022. (V\_501\_2013)

## SHKURT

- Në fillim të muajit shkurt KOSTT-in e kanë vizituar delegacionet e Bankës Botërore dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim më të cilët është diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit në zhvillimin e infrastrukturës së transmisionit dhe mbështetjes në zhvillimin e KOSTT.

## MARS

- Në mbledhjen e Bordit të ZRE të mbajtur me 01 mars 2013, në bazë të kërkesës së KOSTT është aprovuar Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës. (V\_505\_2013)
- Me 30 Mars 2013 u energjizua linja e rindërtuar e tensionit të lartë 110 kV nr.125/2 që lidhë Nënstacionet NS 110/35 kV Vushtrria 1 me NS 110/35/6.5 kV Trepça.
- Me 23 mars 2013 u organizua një Tryezë Pune ku u prezantua Studimi mbi Sigurinë e Furnizimit me Energji Elektrike në Kosovë (SFEE). Objektivi e Studimit ishte analizimi i disa skenareve për të parashikuar zhvillimin e kërkesës për energji elektrike në



vend, adekuacinë e gjenerimit të energjisë elektrike, funksionimin e tregut të energjisë elektrike si dhe shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme, të gjitha këto elemente që ndikojnë në sigurimin e furnizimit me energji elektrike në Kosovë deri në vitin 2030. Studimi në fjalë, gjithashtu përmbanë edhe komponentën e operimit të përbashkët me Republikën e Shqipërisë si mundësi e sigurimit të furnizimit me energji elektrike, dhe e cila është treguar se ka tendenca të ndikimit në rënien e çmimeve të energjisë elektrike.

## PRILL

- Me 23 prill 2013, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT me bashkëpunëtorë, priti në takim në Nënstacionin Kosova B zv. Presidentin e parë të KfW-së për Evropën Juglindore dhe Turqinë, z. Tiskens. Gjatë takimit u diskutua rreth progresit të projekteve në vazhdim që financohen nga Qeveria Gjermane.



## MAJ

- Në muajin Maj është bërë ndryshim në strukturën udhëheqëse të KOSTT pas emërimit të z.Fadil Ismajli, Ministër i Zhvil-

limit Ekonomik në Qeverinë e Kosovës. Nga muaji Maj, KOSTT udhëhiqet nga z.Naim Bejtullahu me profesion Inxhinier Elektrik. Z.Bejtullahu mban një eksperiencë mbi 35 vjeçare në operim të sistemeve të transmisionit dhe shpërndarjes, si dhe në rregullim të sektorit të energjisë si komisioner. Para emërimit Kryeshef Ekzekutiv i KOSTT, z.Bejtullahu ka ushtruar funksionin e zv.Kryeshefit për Zhvillim.

## QERSHOR

- Me 6 Qershor 2013, një delegacion i lartë nga Qeveria Gjermane udhëhequr nga z.Stefan Mironjuk, Drejtor për Kosovë në Ministrinë për Bashkëpunim Ekonomik, Ambasada Gjermane në Kosovë dhe KfW, vizituan Nënstacionin Kosova B, që njëherit është Nënstacioni kryesor në Sistemin e Transmisionit të Kosovës. Gjatë takimit u prezantuan në mënyrë të përmbledhur benefitet nga projektet e financuara nga Qeveria Gjermane.



## KORRIK

- Në muajin Korrik ka filluar realizimi i projektit për rehabilitimin e fasadës së ndërtesës afariste të KOSTT.

## GUSHT

- Në kuadër të përkushtimit të vazhdueshëm të KOSTT sh.a, për zhvillimin e Sistemit Transmetues të energjisë elektrike të Republikës së Kosovës, krahas projekteve të tjera, është implementuar edhe projekti për Reha-

bilitimin e Stabilimenteve të Tensionit të Lartë në Nënstacionet NS 110/35/10 kV Ferizaj 1 dhe NS 110/35 kV Gjilani 1.

## SHTATOR

- Me 8 Shtator 2013 u nënshkrua Marrëveshja për Energji në mes të Kryeministrit të Kosovës z.Hashim Thaçi dhe Kryeministrit të Serbisë z.Ivica Daçiç nën ndërmjetësim të Bashkimit Evropian, përkatësisht Baroneshës Catherine Ashton. Me Marrëveshjen për Energji e cila përmban dy komponente kryesore, është krijuar baza për normalizimin e çështjeve në fushën e energjisë në mes të dy vendeve në: - Çështjet që ndërlidhen me Sistemet e Transmisionit si dhe - Çështjet që ndërlidhen me normalizimin e furnizimit me energji elektrike në pjesën veriore të Kosovës.
- Më 23 Shtator 2013, në ambientet e Ministrisë së Financave në Prishtinë u nënshkrua Marrëveshja për Kredi me KfW përmes së cilës do të bëhet financimi i disa projekteve për zhvillimin e infrastrukturës së transmetimit të energjisë elektrike në Kosovë. Kjo është kredia e dytë komerciale që Qeveria Gjermane përmes Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW) i akordon Republikës së Kosovës, me qëllim të financimit të gjashtë projekteve të KOSTT. Marrëveshja parasheh sigurimin e kredisë komerciale afatgjate nga KfW me kushte kredituese të buta në vlerë prej € 23,5 milion nga e cila € 15,5 milion me periudhë kthyese prej 15 viteve dhe €8 milion me periudhë kthyese prej 40 viteve, si dhe financimin shtesë në formë granti nga Komisioni Evropian në vlerë prej € 7.3 milion përmes programit IPA.



## TETOR

- KOSTT është përfaqësuar në 6th Balkan Energy Finance Forum-Powering Future Growth in SEE. Në Forum, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Naim Bejtullahu mbajti një prezentim para të pranishmëve me titull Siguria e Furnizimit me Energji Elektrike në Kosovë dhe Tregu i Përbashkët Kosovë-Shqipëri. Prezentimi i z.Bejtullahu zgjoi interesim nga ana e të pranishmëve. Gjithashtu KOSTT është prezentuar edhe në panelin e ekspertëve me temën Tregu i energji elektrike në Ballkan, ku u shpjeguan për të pranishmit shumë çështje rreth funksionimit të tregut të energjisë në Kosovë.



## NËNTOR

- Me 24 nëntor, një delegacion i Operatorit të Sistemit të Transmisionit të Shqipërisë (OST) udhëhequr nga zv.Administratori Ekonomik z.Dritan Ceca vizitoi KOSTT-in. Qëllimi i vizitës ishte zhvillimi i mëtutjeshëm i klimës së bashkëpunimit në mes të dy kompanive simotra.



## DHJETOR

- Me 21 Dhjetor 2013, në hapësirat e Lidhjes së Prizrenit në Prizren, u nënshkrua kontrata për ndërtimin e linjës interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri. Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Naim Bejtullahu nënshkroi kontratën me përfaqësuesit e kompanisë kroate Dalekovod e cila do të realizojë ndërtimin e linjës në pjesën e Kosovës, ndërkaq z.Engjëll Zeqo, Administrator i Përgjithshëm i OST Shqipëri, nënshkroi kontratën me përfaqësuesit e kompanisë Energoinvest nga Bosna dhe Hercegovina e cila do të realizojë ndërtimin e linjës në pjesën e Republikës së Shqipërisë.



- Me 27 dhjetor 2013, Zyra e Rregullatorit të Energjisë në bazë të kërkesës së KOSTT, ka marrë vendim për aprovimin e "Rregullave të Tregut" (V\_601\_2013)

# Indeksi i tabelave

<b>Tab 1</b>	Vendimet e Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2013	17
<b>Tab 2</b>	Të dhënat sipas bilancit të realizuar	21
<b>Tab 3</b>	Indikatorët e performancës	23
<b>Tab 4</b>	Gjatësia e linjave transmetuese dhe kapaciteti transmetues i tyre	26
<b>Tab 5</b>	Vjetërsia e linjave të rrjetit të KOSTT për vitin 2013	27
<b>Tab 6</b>	Numri i nënstacioneve ne bazë të auto transformatorëve të KOSTT për vitin 2013	28
<b>Tab 7</b>	Kapacitetet transformuese të auto transformatorëve të KOSTT për vitin 2013	28
<b>Tab 8</b>	Kapacitetet e instaluara transformuese te transformatorëve te KOSTT per vitin 2013	28
<b>Tab 9</b>	Kapacitetet e interkoneksionit për vitin 2013	29
<b>Tab 10</b>	Struktura e të punësuarve në KOSTT	48
<b>Tab 11</b>	Caqet e vendosura me Planin e Biznesit	51
<b>Tab 12</b>	Pasqyra e pozicionit financiar me 31.12.2013	53
<b>Tab 13</b>	Pasqyra e të hyrave gjithëpërfshirëse 31.12.2013	54
<b>Tab 14</b>	Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	55
<b>Tab 15</b>	Pasqyra e rrjedhës së parasë	57

# Indeksi i figurave

<b>Fig 1.</b> Harta e Sistemit të Transmisionit të Kosovës, 31.12.2013	14
<b>Fig 2.</b> Energjia e pafurnizuar dhe disponueshmëria e rrjetit të transmisionit për disa vite	23
<b>Fig 3.</b> Humbjet në Transmision 2006-2013	24
<b>Fig 4</b> Konsumi dhe piku 200-2013	25
<b>Fig 5</b> Konsumi bruto i Kosovës për vitet 2011-2013	25
<b>Fig 6</b> Lakorja e kohëzgjatjes së ngarkesës 2013	26
<b>Fig 7</b> Moshja e linjave e shprehur në përqindje	27
<b>Fig 8</b> Numri i aseteve sipas nivelit të tensionit për vitin 2013	29
<b>Fig 9</b> Krahasimi i numrit të aseteve të rrjetit të KOSTT për vitet 2012 dhe 2013	30
<b>Fig 10</b> Krahasimi në mes të planifikimit dhe realizimit të mirëmbajtjes për linja në 2013	30
<b>Fig 11</b> Krahasimi në mes të planifikimit dhe realizimit të mirëmbajtjes për nënstacione në 2013	31
<b>Fig 12</b> Krahasimi i intervenimeve emergjente në nënstacione për vitet 2009-2013	31
<b>Fig 13</b> Krahasimi i intervenimeve në linja për vitet 2009-2013	32
<b>Fig 14</b> Krahasimi i rënieve të LP për vitet 2011-2013	32
<b>Fig 15</b> Krahasimi i rënieve të ATR dhe TR për vitet 2011-2013	33
<b>Fig 16</b> Disponueshmëria e LP për vitin 2013	33
<b>Fig 17</b> Disponueshmëria e ATR dhe TR për vitin 2013	34
<b>Fig 18</b> Zhvillimi i kapaciteteve interne të rrjetit të transmisionit 2009-2013	36
<b>Fig 19</b> Zhvillimi i kapaciteteve ndër vite	37
<b>Fig 20</b> Rrjedhat ndërkufitare, Prodhimi dhe Konsumi gjatë vitit 2013	41
<b>Fig 21</b> Energjia e tregtuar në zonën tregtare të Kosovës gjatë vitit 2013	42
<b>Fig 22</b> Numri i palëve të regjistruara në treg gjatë 5 viteve	42
<b>Fig 23</b> Importi dhe Eksporti 2009-2013	43
<b>Fig 24</b> Paraqitja në MWh e jo-balanceve të sistemit për vitin 2013	44
<b>Fig 25</b> Struktura Organizativee KOSTT	47
<b>Fig 26</b> Raporti i Auditorit të Pavarur	52

## PËRGATITJA E RAPORTIT VJETOR 2013 KOORDINUAR NGA:

*Zyra për Komunikim dhe Relacione me Publikun*

Me kontributin e punonjësve të KOSTT:

**Besim Gërxhaliu, Bukuriye Dauti, Edita Bytyqi, Elvane Devexhi-Osmeni, Gazmend Kabashi, Gonxhe Haziri, Ilir Shala, Jusuf Imeri, Kadri Kadriu, Kimete Fazliu, Milazim Zeka, Naim Bejtullahu, Nasip Bresilla, Nebih Haziri, Nergize Reznici, Resmije Ahma, Sabri Musiqi, Sadudin Havolli, Safete Orana, Sherif Dedaqi, Skender Gjonbalaj, Visar Hoxha, Vjosa Reznici, Zana Bajrami-Rama.**

Fotografite:

**KOSTT sh.a**

Dizajni, ilustrimet dhe radhitja:

**ASHA**

[www.ashagraphics.com](http://www.ashagraphics.com)

**Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregut- KOSTT sh.a**

Rr. Iljaz Kodra pn

10000 Prishtinë

Republika e Kosovës

Tel: +381 (0) 38 501 601 5

Fax: +381 (0) 38 500 201

E-mail: [info@kostt.com](mailto:info@kostt.com)

web: [www.kostt.com](http://www.kostt.com)





